



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:264644
Datë: 12.11.2020
Numri i dokumentit: 01266348

A.nr. 1177/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Vjollca Limani, procesmbajtësen/zyrtaren ligjore Gzona Rama Demaj, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NN “A.” SHPK, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit firma “J.”, konkretisht av. A.D., kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson P. Gj., zyrtarë i lartë ligjor, me bazë juridike “anulim aktvendimi”, në shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me dt.03.11.2020 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit NN “A.” SHPK, me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi i Komisioni të Pavarur për Miniera dhe Minerale, me nr.prot.25/3, i datës 07.06.2017 dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura, si e pabazuar.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Përfaqësuesi i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor precizoi pikën 2 të kërkesëpadiës ashtu që propozojë gjykatës që të anulohet aktvendimi rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura, në pjesën tjetër qëndroi në tërësi si në parashtrimet e padisë. Ndërsa nëpërmes padisë, paditësi ka theksuar: me datë 25.06.2009 NPTT “G.” dhe NN “A. lidhën kontratën për shitblerjen e pajisjes dhe bartjes të së drejtës së shfrytëzimit të gurorës. Rrjedhimisht, më 16.03.2011 KPMM aprovoi Licencën për Shfrytëzim nr.1019/KPMM/2011 për shkëmb të fortë në emër të paditësit, me anën e së cilës i padituri e autorizon paditësin që të shfrytëzoj shkëmb të fortë brenda zonës së licencës, zonë kjo që përfshin 38428.24 m2. Në të njëjtën licencë, i padituri e kishte përcaktuar se është valide për 13 vite, më saktësisht nga 16.03.2011 deri me 15.03.2024. Dy vite më vonë, KPMM me datë 27.05.2013 për paditësin ka aprovuar lejën për kryerjen e punëve të seperacionit. Në lejën në fjalë është përcaktuar zona e lejës mbulon sipërfaqen prej 2590.39 m2 dhe se kjo leje do të vlente deri me datë 15.03.2016. Pas skadimit të saj paditësi i drejtohet të paditurës me kërkesë për aprovimin e kësaj leje edhe më tutje dhe pas shqyrtimit të saj e paditura me datë 31.05.2017 nxorri vendimin nr.25/3 me të cilin refuzoi këtë kërkesë, me theks të veçantë lejimin e ushtrimit të veprimtarisë së seperacionit në lokacioni e Bellopojës në Komunën e Pejës. Duke qenë se arsyetimi është element thelbësor në përmbajtjen e një akti

administrativ, paditësi i kujton gjykatës që vendimi i nxjerr nga e paditura me nr.23/5 shquhet për mungesën e tij dhe si i tillë duhet të refuzohet si absolutisht i pavlefshëm sic është përcaktuar me nenin 52 të Ligjit për Procedurën Administrative (LPA). Vendimi në fjalë duhet të cilësohet i paligjshëm, meqë i njëjti është nxjerr në kundërshtim me dispozitën e nenit 48 të LPA. Vendimi i të paditurës nuk përmban asnjë nga elementet e numëruar në nenin 48 të LPA, i paditura me aktvendimin e tij nuk bënë asgjë tjetër vetëm se njofton paditësin që Bordi i KPMM në një datë të caktuar kishte pranuar një shkresë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me anën e së cilës ishte njoftuar se ngastra kadastrale në kuadër të së cilës po planifikohej të bëhej seperimi i gurit gëlqeror ndodhej brenda territorit të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”. Sidoqoftë, i padituri dështon të arsyetojë relevancën e lokacionit në të cilën po planifikohej të bëhej seperimi i gurit gëlqeror me vet njoftimin që ka pranuar nga Ministria dhe se çfarë kufizimesh do të ketë lokacioni në lidhje me ligjin për parkun nacional të Bjeshkëve të Nemuna, duke dështuar kështu të arsyetojë refuzimin e kërkesës. Ligji në fjalë në përmbajtjen e tij nuk përmban asnjë dispozitë e cila do të implikonte moslejimin e ushtrimit të veprimtarisë në fjalë, e aq më tepër ky ligj nuk përmban ndonjë dispozitë e cila do të i jepte të drejtë të paditurit në refuzimin e kërkesës së paditësit.

Përfaqësuesi i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi: qëndrojmë prapa përgjigjes në padi, shton se aktvendimi i atakuar nga ana e paditësit është i lëshuar në pajtim me Ligjin e Procedurës Administrative, i njëjti ka dispozitivin, arsyetimin dhe gjithashtu përmban edhe arsyen se përse i është refuzuar paditësit kërkesa për leje për aktivitet të veçant-seperacion. Ky aktvendim në bazën ligjore thirret në nenin 59 par 1, 62, 38, 39 dhe 40 të Ligjit për Miniera dhe Minerale nr.03/L-163. Neni 38 përcakton kërkesat për leje për aktivitet të veçant, ku në paragrafin 1 pika 7 përcakton se aplikuesi ndër kërkesat e tjera duhet të prezantoj tek KPMM pëlqimin mjedisor nga MMPH tash MEA. Ne dëshirojmë të sqarojmë se leja herën e parë është lëshuar për kompaninë “G.”, e cila njeherit ka prezantuar pëlqimin mjedisor, në faqen 2 të të cilit është e shënuar: “Pas shpalljes së Bjeshkeve të Nemuna Park Nacional, ky pëlqim do të trajtohet në harmoni me legjislacionin për rregullimin e hapësirës së caktuar në kuadër të vendit ku zhvillohet veprimtaria e kësaj kompanie. Në lidhje me këtë aktivitet palës me vendim të ri do ti ndalohet aktiviteti i veprimtarisë”. KPMM para marrjes së vendimit, paditësit i ka dërguar dy njoftime, njoftimin me nr.1983 dhe 5029. Me njoftimin 1983 është njoftuar se pëlqimi nga MPMH është i lëshuar nga Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse, dhe se fusha e sepreacionit bie mbi zonën e Parkut Nacional. Në njoftimin e fundit përkatësisht shkresën me nr.5029 ne i kemi sqaruar paditësit se do të kërkojë informata shtesë nga MMPH në lidhje me zonën dhe konstatoj se a ekziston mundësia që paditësit ti vazhdohet leja për aktivitet të veçantë. MMPH pastaj na ka dërguar shkresë sipas së cilës paditësit nuk i lejohet të bëjë eksploatin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror për shkak se zona në fjalë ndodhet në territorin e parkut nacional Bjeshkët e Nemuna. Andaj në bazë të kësaj KPMM ka marr vendim me të cilën e ka refuzuar kërkesën për leje, mirëpo në çdo moment kur kompania paditëse arrin që ta sjell pëlqimin e ri mjedisor KPMM mund ti lëshoj të njëjtës leje për aktivitet të veçant.

Pas deklarimit të palëve ndërgjyqëse, Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt. 03. 11. 2020, ka bërë administrimin e provave, dhe atë është administruar: Kontrata mbi shitblerjen e paisjes dhe bartjes të së drejtës së shfrytëzimit të gurorës e lidhur me datë 25.06.2009; Licenca për shfrytëzim nr.1019/KPMM/2011 e datës 16.03.2011; Leja për aktivitete të veçanta nr.317/KPMM/2013, për të kryer punët seperacion duke përfshirë seperacion e dt.27.05.2013; Aktvendimi me nr prot 25.03 i datës 08.06.2017, i shoqëruar me dëshminë e dorëzimit; Njoftimi i lëshuar nga KPMM me datë 06.05.2016, i shoqëruar me dëshminë e dorëzimit; Njoftimi i lëshuar nga KPMM i datës 04.11.2016, i shoqëruar me dëshminë e dorëzimit; dokumenti me

lëndën “Përgjigje në kërkesën për pëlqim mjedisor lidhur me projektin për eksploatimin, thermimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në Brestovik KK Pejë” me nr prot.545 i dt.16.10.2012; Vendimi i lëshuar nga QRK_MMPH me nr.05/2606/0-ZSDP-1431 i dt.02.05.2007; dokumenti me subjektin “Përgjigje në shkresë” i datës 28.04.2017; dokumenti me lëndën “Propozim i përgjegjës për KPMM i datës 19.04.2017”; dokumenti me subjektin “Informata shitesë për parkun nacional Bjeshket e Nemuna” i datës 12.04.2017; dokumenti me lëndën: “Përgjigje në kërkesën për pëlqimin mjedisor lidhur me projektin për eksploatimin, thermimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në Brestovik KK Pejë” “ me nr prot 1181 i datës 13.08.2009; Pëlqimi i lëshuar nga MBPZHR- Agjencia Pyjore Ref.KE 769/10 i dt.07.12 2010.

Me vendimin me nr.prot. 25/3 të datës 07.06.2017 e paditura KPMM kishte refuzuar kërkesën e paditësit NN A. SHPK, për Leje për aktivitete të veçanta- Seperacion, në vendin e quajtur Bellopoj KK Pejë.

Paditësi i pakënaqur me këtë aktvendim, me datën 13.07.2017, ushtron padi në këtë gjykatë duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ (më tutje LKA-së) dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e **pabazuar**.

Gjykata me rastin e vlerësimit të ligjshmërisë mori parasysht Ligjin për Procedurën e Përgjithëshme Administrative, Ligjin për Miniera dhe Minerale 03/L16, Ligjin për vlerësimin e ndikimit mjedisor 03/L214 dhe Ligji për mbrojtjen e natyrës nr.03/L-233.

Kështu në Ligjin për Miniera dhe Minerale 03/L16, me dispozitën e nenit 13 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12, është përcaktuar:

1. Bartësi i Licencës ose Lejes për Shfrytëzim nuk do të ushtrojë asnjë veprimtari në ndonjë sipërfaqe që: 1.12. është brenda një zone të caktuar me ligj dhe zyrtarisht si park nacional ose komunal;

Ndërsa me nenin 38 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 është paraparë:

1. Personi që kërkon të ndërmerë aktivitete të veçanta duhet t'i dorëzojë KPMM-së një kërkesë të plotë për lëshimin e Lejes për kryerjen e aktiviteteve të veçanta në fjalë. Kërkesa duhet të dorëzohet në formën e paraparë dhe me taksën e paguar, dhe asaj i bashkëngjitet: 1.7. pëlqimin mjedisor të lëshuar nga MMPH dhe çfarëdo miratime tjera nga Autoritete tjera Publike të cilat kërkohen sipas ligjit të Kosovës;

Ligji për vlerësimin e ndikimit mjedisor 03/L214, në dispozitën e nenit 8 Transferi i Pëlqimit Mjedisor, në paragrafi 1 ka theksuar: *Në rast se aplikuesi për pëlqim mjedisor, ose poseduesi i një pëlqimi mjedisor të cilit i referohet neni 7 i këtij ligji, planifikon të transferojë atë kërkesë ose pëlqim te ndonjë person tjetër, - trashëguesi, aplikuesi për pëlqim mjedisor ose poseduesi i atij pëlqimi dhe trashëguesi duhet të paraqesin një kërkesë të përbashkët në Ministri lidhur me atë transferim.*

Dhe krejt në fund Ligji për mbrojtjen e natyrës nr.03/L-233, në nenin 11 paragrafi 4, ka përcaktuar: *“Në parkun kombëtar ndalohet shfrytëzimi ekonomik i të mirave të natyrës”.*

Përveç referimeve ligjore si më lartë, Gjykata shqyrtoi dhe pati parasysht provat e administruara në seancë të shqyrtimit kryesor: kështu nga Kontrata për shitblerjen e pajisjes dhe bartjes të

drejtës të shfrytëzimit të gurores, e lidhur me dt.25.06.2009, vërehet se NPTT G.- si shitës i kishte shitur paditësit- si blerës pajisjet për thyerjen dhe seperimin e gurit dhe makineri të tjera përcjellëse si dhe i kishte bartur të drejtën e shfrytëzimit të aseteve duke përfshirë në këtë rast edhe Pëlqimin mjedisor Komunal dhe të MPMH. Bartje kjo e Pëlqimit nga NPTT “G.” në NN “A.” në kundërshtim me dispozitën e nenit 8 të Ligji për vlerësimin e ndikimit mjedisor 03/L-214.

Mirëpo edhe sikur kjo bartje të mos ishte në kundërshtim me ligjin në fjalë, Vendimi me të cilin aprovohet kërkesa e kompanisë NP “G.” për pëlqim mjedisor lidhur me projektin për eksploatimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqëror në Brestovik KK Pejë, vërehet se në pjesën e fundit të tij përmban konstatimin “Pas shpalljes së Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional, ky pëlqim do të trajtohet në harmoni me legjislacionin për rregullimin e hapësirës së caktuar në kuadër të vendit ku zhvillohet veprimtaria e kësaj kompanie. Në lidhje me këtë aktivitet palës me vendim të ri do të ndalohet aktiviteti i veprimtarisë”. Do të thotë paditësi vec se ka qenë dijeni se me hyrjen në fuqi të Ligji për Parkun Nacional, i cili ligj është publikuar në gazetën zyrtare me 21 janar 2013 dhe ka hyr në fuqi 15 ditë pas publikimit, do të ndalohet aktiviteti i veprimtarisë, për të cilën ai vec se kishte lidh kontratë me NPT “G.”- bartëse e këtij pëlqimi mjedisor.

Nga dokumenti më subjektin “Propozim i përgjegjës për KPMM” i datës 19.04.2017, me nr.prot.2047/17, i lëshuar nga MPMH-Departamenti i Mjedisit, bëhet e qartë se kjo Ministri me datë 19.09.2012, me vendimin nr. prot12/2285/1-/ZSP-/12, kishte refuzuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor për paditësin lidhur me projektin për eksploatimin, thërrmimin, seperimin e gurit gëlqëror në ngastrën kadastrale nr.254, fletëposedimi nr.92 ZK Brestovik, Komuna e Pejës, pasi që ngastra në fjalë ndodhet brenda territorit të Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna.

Prandaj duke pasur parasysh këto prova del se paditësi paraprakisht ka qenë i njoftuar se pëlqim për zonën në fjalë do të varet nga Ligji për Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna apo ligjet e tjera përkatës, mbi bazën e të cilit edhe ishte refuzuar kërkesa për pëlqim nga MPMH, prandaj mbi këtë bazë ishte refuzuar edhe nga e paditura Kërkesa për Leje për aktivitete të veçanta-Seperacioni. Prandaj nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit se vendimi në fjalë nuk përmban arsyetim për refuzim e kërkesës dhe se i njëjti nuk është i bazuar në ligj, duke qenë si e njëjti krahas arsyetimit është i bazuar në ligj, konkretisht nenin 38, 39 dhe 40 të Ligjit për Miniera dhe Minerale.

Prandaj, Gjykata konstaton se e paditura drejtë ka vendosur kur ka refuzuar Kërkesën për Leje Aktivitete të Vecanta-Seperacion në vendin e quajtur Bellopoj KK Pejë, pasi që është konstatuar se nuk i ka përmbushur kushtet për tu paisur me këtë leje, konkretisht nuk është paisur me pëlqim mjedisor nga MPMH, sic është përcaktuar me dispozitën e nenit 38 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 të Ligjit për Miniera dhe Minerale dhe duke qenë nuk janë përmbushur këto kushte ka vendosur konfrom nenit 39 të LMM për refuzim të kërkesës. Në anën tjetër po ashtu edhe neni 13 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12, i LMM ka përcaktuar se: “*Bartësi i Licencës ose Lejes për Shfrytëzim nuk do të ushtrojë asnjë veprimtari në ndonjë sipërfaqe që: 1.12. është brenda një zone të caktuar me ligj dhe zyrtarisht si park nacional ose komunal*”, sic është rasti në fjalë ku zona objekt i kërkesës gjendet brenda territorit të parkut nacional Bjeshkët e Nemuna.

Mbi këtë gjendje të fakteve Gjykata konstaton se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit.

Gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative, drejtë janë zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative dhe të ligjit material.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur duke u bazuar në nenin 64 të LKA-së që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës

Duke u bazuar në të dhënat e lartë cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr. 1177/17 data 03.11.2020

Zyrtarja Ligjore
Gzona Rama Demaj

G j y q t a r j a
Vjollca Limani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.